## 1. Projekti i Asistencës Suedeze

Pas evidentimit të nevojave për zhvillimin e kapaciteteve të veta, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sapo ka filluar një projekt asistence nga administrata tatimore e Suedisë, me financim nga SIDA (Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar). Administrata jonë tatimore do të asistohet nga ajo e Suedisë për përmirësimin e punës dhe proceseve kryesisht në fushat dhe funksionet si vijon:

1. Sigurimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit
2. Ngritja e kulturës së integritetit të punonjësve të administratës tatimore
3. Gjurmimi i mashtrimeve tatimore
4. Kontroll tatimor më efikas
5. Metoda efikase të përdorimit të të dhënave të marra nga Juridiksionet Kompetente, në kuadër të Shkëmbimit Automatik të Informacionit të llogarive financiare. Evidentimi i nevojave për përditësimin e sistemeve informatike të administratës tatimore, për të arritur ndërlidhjen me sistemet e BE-së në momentin e anëtarësimit.

Gjatë vitit 2021 do të vijohet me evidentimin e detajuar të nevojave tona për secilën prej fushave të mësipërme, për të vijuar më tej me zbatimin konkret të Projektit, përgjatë periudhës 2022-2024.